



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 314/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) me seli në Prishtinë, për shkak të manipulimit të emërave të kandidatëve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. PZAP-i shpallet inkompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.
- II. Shkresat e lëndës ti dërgohen Prokurorisë Publike Kompetente në procedurë dhe vendosje te më tejshme.

Arsyetim

Me datë 10.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik KTAP ku pretendohet se disa subjekte politike janë marrë me aktivitete të ndryshme dhe kanë tentuar që të ndikojnë në procesin zgjedhor të votuesit. Më tutje ka shtuar se, një rast i tillë ka ndodhur në Komunën e Mamushës, ku nga subjekti KDTP në listën për anëtarë të këtij subjekti për kandidatë ishte Elmaz Zogaj, ndërsa në posterat dhe bilbordat e saj ka qenë e vendosur fotografia e Leonora Zogaj.

Për më tepër theksohet se me këto veprime është bërë mashtrim ndaj qytetarëve si dhe keqpërdorim i personave të mitur.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që në Komunën e Mamushës të anulohet të gjitha votat e marra nga ana e subjektit politik KDTP.

Në cilësi të provës ka bashkangjitur fletë listën e emërave të kandidatëve, çertifikatën e lindjes së Elmaz Zogaj dhe Leonora Zogaj dhe tri fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.

Pretendimet ankimore se është e certifikuar nga KQZ-ja kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik KDTP Elmaze Zogaj, ndërsa gjatë periudhës së fushatës zgjedhore janë publikuar posterat me fotografimin e motres së saj Leonora Zogaj e cila nuk është e certifikuar si kandidate nga KQZ-ja, PZAP-i konsatton se për pretendime të tilla nuk ka juridiksion që të vendosë andaj në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 314/2014 më datën 12.06.2014



Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha